

VENDIM
Nr. 148, datë 24.6.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PËR VITIN 2021 DHE PËRDITËSIMIN E PLANIT DHJETËVJEÇAR
2015–2025, TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË OST
SHA**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “e”, nenit 60, pikat 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 6, 7, 9, 10, 11, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 135, datë 6.9.2017, si dhe nenit 15 dhe 19, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 95/4 prot., datë 22.6.2021, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2021, dhe përditësimin e planit dhjetëvjeçar 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”, e përgatitur nga grupi i punës, ngritur me urdhër të kryetarit të ERE-s nr. 41, datë 28.5.2021,

konstatoi se:

- Shoqëria Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) përmes shkresës nr. 2602 prot., datë 16.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 603 prot., datë 19.4.2021, ka përcjellë kërkesën për shqyrtim të planit të investimeve për vitin 2021.

- Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 2602/1 prot., datë 18.5.2021, OST sh.a. ka përcjellë në ERE sqarime shtesë, në lidhje me planin e investimeve të shoqërisë për vitin 2021.

- Plani i investimeve për vitin 2021 është miratuar nga Këshilli i Mbikëqyrjes së OST sh.a., me vendimin nr. 19, datë 17.12.2020, “Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a., për vitin 2021”. Në këtë vendim janë miratuar Treguesit e Programit të Zhvillimit Ekonomik për vitin 2021.

- OST sh.a., ka bërë gjithashtu me dije se përmes shkresës nr. 2389/4 prot., datë 27.1.2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) ka shprehur qëndrimin e saj, duke miratuar treguesit kryesorë të Programit të Zhvillimit për vitin 2021, sipas vendimit nr. 19, datë 17.12.2020, të Këshillit Mbikëqyrës të OST sh.a.

- Miratimi i planit të investimeve është një proces mjaft i rëndësishëm edhe pse i vonuar në kohë, për arsye të mosparaqitjes së aplikimit për miratimin e planit të investimeve për vitin 2021 konform përcaktimeve të pikës 5, të nenit 60, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Në dokumentacionin e përcjellë, shoqëria OST sh.a. ka paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet e vitit 2021, në të cilin evidenton dhe aftësinë e saj financiare për të përballuar kryerjen e investimeve të parashikuara për t’u realizuar gjatë vitit 2021.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OST sh.a. konstatohet, se:

- Shoqëria ka përcjellë informacion shpjegues lidhur me zërat e investimeve të planifikuara në zbatim të kërkesave të përgjithshme të hartimit të planit të investimeve në mbështetje të përcaktimeve të Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, e më konkretisht:

- raportim mbi aktivitetin e OST sh.a. dhe zbatimin të planit të investimeve për vitin 2020;
- informacion mbi planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit;

- informacion mbi planifikimin e aktivitetit dhe planin e investimeve për vitin 2021;
- parashikimi i kërkesës për vitin 2021 dhe mënyra e mbulimit të saj;
- planifikimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve për vitin 2021;
- informacion mbi projektet e investimeve me fonde të huaja, për vitin 2021;
- informacion mbi projektet e investimeve me fonde të OST sh.a. për vitin 2021;
- listën e projekteve që do të zbatojë gjatë vitit 2021.

- Duhet të paraqitet një raport vjetor mbi zbatimin e planit të investimeve të vitit 2020, duke treguar ecurinë e investimeve të planifikuara për t'u realizuar dhe duke siguruar shpjegim nëse ka pasur ndryshime në planin e investimeve të periudhës paraardhëse në zbatim të pikës 2, të nenit 7.

- Shoqëria duhet të përcjellë informacion shpjegues dhe dokumentacion plotësues mbështetur në përcaktimet e rregullores, për investimet e reja, të cilat priten të realizohen gjatë vitit 2021 me fonde të huaja, si dhe një raport mbi zbatimin dhe ecurinë e investimeve të kryera me fondet e huaja, të cilat janë miratuar nga ERE në periudhat e mëparshme.

- Duhet të paraqitet informacion lidhur me publikimin e planit të investimeve të vitit 2021 apo dhe përditësimit të planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, duke iu dhënë mundësinë të interesuarve përfshirë dhe institucionet e ndryshme shtetërore të japin komentet e tyre lidhur me këto plane në zbatim të germës “P”, të nenit 6.

- Në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 8, duhet të paraqitet informacion sqarues dhe dokumentacion plotësues lidhur me kërkesat e përcaktuara në gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”.

- Në zbatim të përcaktimeve të pikës 4, të nenit 8, duhet të paraqitet informacion sqarues dhe dokumentacion plotësues, lidhur me kërkesat e përcaktuara në gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”.

- Në zbatim të paragrafit të parë të nenit 10, duhet të përcillet informacion dhe dokumentacion mbi konsultimin e planit të investimeve me palët e interesuara, ku ndër më të rëndësishmet janë konsultimi me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) për projektet në kufijtë e pronësisë midis dy sistemeve dhe atyre që kanë ndikim të ndërsjellët për të dy shoqëritë, me qëllim parashikimin me efektivitet të investimeve të dy operatorëve.

- Informacioni i përcjellë vlerësohet i mjaftueshëm për të vijuar me fillimin e procedurës së shqyrtimit të planit të investimeve.

- Mangësitë e konstatuara në këtë vendim, si dhe të tjera të cilat do të rezultojnë gjatë procesit të shqyrtimit të planit të investimeve duhet të plotësohen nga OST sh.a., me qëllim përfundimin e procedurave të shqyrtimit të planit të investimeve për vitin 2021, si dhe përditësimin e “Planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 10-vjeçare, 2015–2025”.

- ERE, për sa parashikohet në pikën 2, të nenit 11, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 135, datë 6.9.2017, do të publikojë njoftimin për paraqitjen e planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga data e pranimit të aplikimit për marrjen e komenteve nga të interesuarit, të cilët mund të paraqesin komentet e tyre brenda 15 ditëve nga publikimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e planit të investimeve të shoqërisë OST sh.a. për vitin 2021, sipas tabelave bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shoqëria OST sh.a. të dërgojë për shqyrtim përditësimin e “Planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 10-vjeçare, 2015–2025”, në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, konform përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 135, datë 6.9.2017, të Bordit të ERE-s.

3. Shoqëria OST sh.a. të depozitojë në ERE, jo më vonë se 60 ditë nga marrja dijëni e këtij vendimi, dokumentacionin dhe informacionet plotësuese, në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”.

4. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve të njoftojë shoqërinë OST sh.a., dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Parashikimi i programit të investimeve të OST sh.a., me fondet e veta, për vitin 2021 (tabela 1)

Nr.	Përshkrimi i projektit	Vlera e kontratës	Vlera për t'u realizuar në 2021
1	Ndërtimi i linjës 110 kV Fier-Hoxharë	250.000.000	50.000.000
2	Ndërtimi i linjës kablore Trana 1-Qendër	100.000.000	20.000.000
3	Zgjerimi N/st Trana1 TR 220/20 63 MVA (Trakti 220 kV, seksioni tretë 20 kV dhe bazamenti TR 63MVA)	100.000.000	50.000.000
4	Ndërtimi i linjës 110 kV Gjuri i Lalat-Fushë Kuqe	300.000.000	60.000.000
5	Ndërtimi N/st të ri 110/35/20 kV Palasë dhe linjës 110 kV	320.000.000	160.000.000
6	Zgjerimi i sistemit të lokalizimit të defekteve në linjat e tensionit të lartë	130.000.000	130.000.000
7	Furnizimi i fitës rezervë 400/220 kV 115 MVA Koman	160.000.000	80.000.000
8	Furnizim dhe vendosje shunt reactor 400 kV 120 MVAr Trana 2	550.000.000	110.000.000
9	Mbakqyrje e punimeve	40.000.000	8.000.000
10	Zgjerimi i kapaciteteve transportuese në pajisjet DWDM (Dizenjimi dhe upgrade DWDM)	47.500.000	47.500.000
11	Zgjerimi i kapaciteteve transportuese në pajisjet MPLS_TP (Dizenjimi, upgrade dhe konfigurimi i rrjetit 10G)	22.500.000	22.500.000
12	O&M Fiber optike / JOINT / BOX ODF / Pjesë rezervë për mirëmbajtje	12.500.000	12.500.000
13	Ndërtimi i ambientit të monitorimit help desk për shërbimet e OST	12.500.000	12.500.000
14	Blerje pajisje teknologjike dhe sistem vizualizimi për Qendrën Kombëtare Dispečer	13.220.000	13.220.000
15	Platformë për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe eventeve	9.750.000	9.750.000
16	Blerje Pajisje IT	16.500.000	16.500.000
17	Upgrade dhe mirëmbajtje e platformës të Matjes Online	28.400.000	28.400.000
18	FV kabina roje tip shelter me përmasa 2*3	2.400.000	2.400.000
19	FV e dyerve, brava dhe lexues aksesit për zonat e sigurisë së lartë në AQ dhe njësi	1.800.000	1.800.000
20	Kosto Lokale e projekteve me financime të huaja	52.937.252	52.937.252
Total 2		2,170,007,252	888,007,252

Parashikimi i programit të investimeve të OST sh.a., me fondet e huaja, për vitin 2021 (tabela 2)

Nr	Pershkrimi i Projektit	Parashikim 2021	
		Per tu disbursuar nga Kredia	
		Valute (Euro)	Leke
1	Projekti " Eficenca energjitike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike"		
	Lot 1 - Substations : • Instalimi i dy transformatorëve 220/110/20 kV me fuqi 150 MVA në Nënstacionin e Rrashbullit. • Ndërtimi i një Nënstacioni të ri Tirana (3) 400/110/20 kV si edhe përforcimi i Nënstacioneve Tirana 1 , Traktori dhe Selita. - Kontraktori EFACEC	8,458,846.56	1,023,520,433.51
	Lot 2: Overhead Lines and Underground Cable Sections: • Ndërtimi i një linje të re me dy qarqe 220 kV Tirana 2 – Rrashbull dhe dy dalje të reja përkatësisht në Nënstacionin Tirana 2 dhe Rrashbull. Ndërtimi i unazës 110 kV: Tirana 1 – Traktori linjë kablore 110 kV, Tirana 3 – Traktori linjë 110 kV pjesërisht kablore dhe pjesërisht ajrore, Tirana 3 – Selita linjë 110 kV pjesërisht kablore dhe pjesërisht ajrore. - Kontraktori ENERGOINVEST	6,930,753.53	838,621,176.86
	Konsulenca Fiditner	360,789.00	43,655,469.00
2	Projekti "Linja 400 kV Shqipëri - Maqedoni"		
	1)Ndërtimi i Linjes së Interkoneksionit 400 kV Elbasan-Btola (Maqedoni); 2)N/Stacioni I Ri 400kV Elbasan 3; 3)Linja Elbasan Fier dhe 4) Nënstacioni Fier. 64,851,000 euro fonde të angazhuara dhe 5,000,000 euro financim I OST.	10,071,282.20	1,218,625,146.20
	Konsulenca Fiditner	761,695.06	92,165,102.56
3*	Projekti "Plani nbi investimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit" MASTERPLAN*		
	Konsulenca AF Consulting		
4*	Fonde të mbetura nga projekti "Linjës 400 kV Shqipëri – Kosovë (Tirana 2- Kosove) B", "Zgjerimi i N/Stacionit 400 kV të HEC Komarit"	589,628.84	71,345,089.64
5*	Fonde të mbetura nga projekti "Linja unazore 110kV e Shqipërisë së jugut", "Ndërtimi i N/Stacioneve të rinj 110/35/20 kV Orikum dhe Himare"	1,481,540.25	179,266,370.25
6	Projekti I rinëkëmbjes së energjisë		
	Instalimi i sistemit të matjes në konsumatorët, fiderat, prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike të lidhur në tension të mesëm**	-	-
	Konfigurimi i 12 nënstatione 110 kV në sistemin ekzistues SCADA/EMS	437,210.3	52,902,447.08
Totali		29,091,746	3,520,101,235